



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žulbe i Predstavke

Anr.350/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Llazić, Afijete Sada – Gllogjani, Fejzullah Rexhepi, Kymete Kicaj, Rrustem Thaqi, Faton Ademi, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjekteve politike: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Koalicioni NISMA-AKR-PD, të gjitha me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të gabimit teknik në Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR), dhe ndikimit të rezultati i publikuar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN të pa lejuara ankesat: Anr.350/2019, e paraqitur nga subjektit Politik PDK, Anr.351/2019, e paraqitur nga subjektit Politik LDK dhe Anr.353/2019, e paraqitur nga Koalicioni NISMA-AKR-PD, të datës 07.10.2019, me të cilën kanë kërkuar që të Urdhërohet KQZ-ja, që të bëjë rinumërimin e të gjitha fletëvotimeve në të gjitha vendvotimet e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2019, PZAP-i, ka pranuar ankesat e evidentuara si: Anr.350/2019, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Anr.351/2019, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe Anr.353/2019, nga koalicioni NISMA-AKR-PD, të gjitha me seli në Prishtinë, të paraqitura ndaj KQZ-së, për gabimet që kanë ndodhur në formularët e rezultateve për partitë politike, në procesin e zgjedhjeve të 6 Tetorit, në të gjitha vendvotimet dhe qendrat e votimit në Kosovë, duke pretenduar se konform argumenteve të ofruara nga komisionerët, vëzhguesit, formularët e rezultateve të partive politike, si dhe dëshmime tjera në vendvotimet e Qendrave të Votimit, kanë ndodhur vendosje të rezultateve në mënyrë të gabueshme, në atë mënyrë që në të gjitha vendvotimet dhe Qendrat e Votimit në Kosovë, nga faktet e ofruara, argumentohet se materiali zgjedhor i cili ka shkuar në vendvotime nga KQZ-ja, për zgjedhjet e 6 Tetorit, ka qenë me defekte, respektivisht formularët e rezultateve në të gjithë Kosovën, në rubrikën ku duhet të shënohen votat e subjekteve politike kanë qenë me një rubrikë

më pak, më saktë nga 25 subjekte politike sa ishin në garë zgjedhore, formulari kishte vetëm 24 rubrika, mungesë përmbajtësore kjo e cila sipas paraqitësve të ankesave ndikon drejtpërsëdrejti në rezultatin final të secilit garues në zgjedhje. Paraqitësit e ankesave, kanë shtuar se nëse shikohet me kujdes formulari në fjalë (FPR), subjektit të parë të certifikuar, për pjesëmarrje në zgjedhje “Partia Liberale Egjiptiane”, me numër 111, nuk i është vendosur fare kolona përkatëse, prandaj është dashur që me rezultatin e këtij subjekti, përshkrimi të fillohet me kolonën e dytë, e cila është paraparë për subjektin politik “Partia Demokratike e Kosovës” me numër 112, gjë kjo e cila ka shkaktuar huti tek anëtarët e KVV-ve, numërues dhe përshkrues të rezultateve dhe shtrembërim të rezultateve në të gjitha vendvotimet e Republikës së Kosovës. Si rezultat i këtij gabimi të KQZ-së, sipas subjekteve ankuese është shkaktuar mosbesim i plotë ndaj rezultatit të subjekteve politike, për shkak të gabimeve të mundshme, me apo pa qëllim, të bëra në vendvotime, gjatë përshkrimit të rezultateve, duke bërë madje që një subjekti politik minoritar, të mos i shënohen fare votat në FPR, gjë e cila shkakton konfuzion shtesë, sidomos kur bëhet fjalë për numërimin e votave të kandidatëve dhe rezultatin final të këtyre zgjedhjeve sepse ndërkohë që subjektit mund të mos i jenë shënuar votat, kandidatët e këtij subjekti mund të kenë vota të shënuara në Formularin e rezultatit të kandidatëve (FRK), e që automatikisht shtrohet dilema se si subjekti politik mund të mos ketë vota, ndërsa kandidatët e tij po. Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pretendon se si pasojë e këtij gabimi, ata janë dëmtuar në rreth 2500 vendvotime, ku rreth 165 mijë vota të këtij subjekti politik, janë vendosur tek subjekti tjetër i afërm - Partia e Ashkalive për Integrim (PAL).

Në fund kanë theksuar se ky gabim, ka luhatur rëndë besimin e qytetarëve dhe të subjekteve politike në procesin zgjedhor, si dhe ka cenuar rëndë integritetin e procesit zgjedhor në Republikën e Kosovës, sepse e ka bërë të pabesueshëm edhe rezultatin final të këtyre zgjedhjeve, me ç’ rast është bërë shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së dhe Rregullave Zgjedhore të KQZ-së, duke kërkuar nga PZAP-i, që bazuar në faktet e ofruara nga paraqitësit e ankesave dhe ato të cilat dalin nga procesi i hetimit, të pezullojë procesin e numërimit dhe të urdhërojë KQZ-në, të bëj rinumërimin e fletëvotimeve në të gjitha vendvotimet në Kosovë.

Paraqitësit e ankesave të lartë cekura, për të vërtetuar pretendimet e tyre, ankesave u kanë bashkangjitur disa formularë të rezultateve (FPR), të printuar, të cilët kanë qenë në përdorim gjatë procesit të votimit, në cilësi të provave materiale.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesave gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.350/2019, Anr.351/2019 dhe Anr.353/2019, të gjitha të datës 07.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e parregullsisë së pretenduar janë të njëjta dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, vendosi

për bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, me rastin e vendosjes, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara si në ankesat e lartë cekura, përkitazi me atë se KQZ-ja, ka dërguar material zgjedhor me gabime teknike në Formularët e Përputhjes së Rezultateve në vendvotime, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, për faktin se shkeljet e pretenduara nga subjektet ankuese sipas ankuesve kanë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve të publikuar deri më tani. Meqenëse palët ankuese kërkesë kryesore të tyre e kanë rinumërimin për shkak të pretendimeve se gabimet teknike në FRP-të, kanë ndikuar në rezultatin e votave për subjektet e tyre, në këtë fazë të procesit zgjedhor të gjitha ankesat që i referohen kontestimit të rezultateve hudhen poshtë si të palejuara sepse rezultatet nuk janë përfundimtare dhe të njëjtat mund të ndryshojnë, e po ashtu korrektimi i gabimeve teknike që i referohen ankuesit, në raport me FPR, tani për tani është në kompetencë të KQZ-së, për korrektim me rastin e auditimit të të gjithave FRP-ve, sipas procedurave të Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR), konform Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013. Pas auditimit të tërësishëm të FRP-ve, QNR-ja, harton raportin me shkrim të rezultateve përfundimtare dhe i njëjti publikohet nga KQZ-ja, ku palët me interes ligjor të njëjtin mund ta ankimojnë.

Hudhja e ankesave të lartë cekura, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesve nuk u mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqesin ankesa të tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZP-it, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 350/2019 më datë 08.10.2019



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*